

VENDIM
Nr. 1086, datë 14.12.2013

**PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË ARKËTIMEVE DHE
ULJEN E NIVELIT TË HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE¹**

*(Ndryshuar me VKM nr.718, datë 30.10.2014; nr.478, datë 11.5.2015; nr.356, datë 11.5.2016; nr.323,
datë 12.4.2017; nr.763, datë 20.12.2017)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të *Infrastrukturës dhe Energjisë*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Kjo Task-Forcë drejtohet nga zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje:

- | | |
|---|------------------|
| - <i>Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë</i> | zëvendëskryetar; |
| - Zëvendësministrin e <i>Infrastrukturës dhe Energjisë</i> | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Punëve të Brendshme | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Drejtësisë | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Financave | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë | anëtar; |
| - Administratorin e <i>Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a.</i> | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Ujësjellës-Kanalizimeve | anëtar. |

3. Task-Forca për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, ka këto funksione:

- Hartimin e një plani masash administrative dhe organizative për fuqizimin dhe rritjen e frytshmërisë së strukturave të *Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a.*, për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve, evidentimin dhe ndërprerjen e lidhjeve e të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe në sistemin e matjes së energjisë elektrike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e *Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a.* dhe institucionet e tjera shtetërore për identifikimin dhe zbatimin e masave në funksion të përmirësimit të nivelit të arkëtimeve të detyrimeve të energjisë elektrike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e *Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a.* për përcaktimin e zonave të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për të cilat kërkohet ndërhyrje emergjente për zbatimin e masave teknike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e Policisë së Shtetit, sipas qarqeve, për mbështetjen e

¹ VKM nr. 1086, datë 14.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.207/2013.

VKM nr. 718, datë 30.10.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.173/2014.

VKM nr.478, datë 11.5.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.98/2015.

VKM nr.356, datë 11.5.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.82/2016.

VKM nr.323, datë 12.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.83/2017.

VKM nr.763, datë 20.12.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.230, 27 dhjetor 2017.

veprimeve në terren të punonjësve të *Operatori të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a.*, gjatë ndërprerjeve të lidhjeve të paligjshme dhe ndërprerjeve për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve të energjisë elektrike.

- Bashkëpunimin me strukturat e Policisë së Shtetit për ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale të depozituara nga *Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a.*

- Kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna për njësitë operative vendore dhe institucionet e tjera të ngarkuara në përputhje me këtë vendim.

- Bashkërendimin e punës me Entin Rregullator të Energjisë për një program të posaçëm që përgatitet nga *Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a.*, ku parashikohet kryerja e investimeve emergjente në funksion të uljes së humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonat më problematike.

- Evidentimin e nevojave emergjente për t'i paraprirë punës me ndryshimet e mundshme të kuadrin ligjor, nënligjor e rregullator, të cilat ndikojnë në përmirësimin e treguesve të nivelit të humbjeve e të nivelit të arkëtimeve të energjisë elektrike dhe përgatitjen e propozimeve përkatëse.

- Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me Entin Rregullator të Energjisë për masat e nevojshme rregullatore që duhet të merren për realizimin e funksioneve themelore të Task-Forcës.

- *Nëpërmjet strukturës së Njësisë Operacionale Speciale, kryen kontrollin pranë konsumatorëve të energjisë elektrike dhe strukturave të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., (OSSHE), për evidentimin dhe ndërprerjen e lidhjeve e të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe në sistemin e matjes së energjisë elektrike.*

4. Brenda datës 31 dhjetor 2013, nën drejtimin e prefektëve sipas qarqeve, të ngrihen njësitë operative vendore, të cilat i raportojnë 1 (një) herë në muaj kryetarit të Task-Forcës për masat e marra dhe rezultatet e arritura për ndjekjen e detyrave të parashikuara në këtë vendim.

5. Task-Forca për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndihmohet nga sekretariati teknik. Ngarkohet *ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë* për ngritjen e këtij sekretariati dhe për përcaktimin e përbërjes e të mënyrës së funksionimit të tij.

5.1 Në mbështetje të Task-Forcës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ngrihet edhe Njësia Operacionale Speciale e Task-Forcës.

5.1.1. Njësia Operacionale Speciale e Task-Forcës kryen këto detyra:

a) Në marrëdhëniet me konsumatorët e energjisë elektrike ka këto të drejta dhe detyra:

- Të kontrollojë ligjshmërinë e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve;

- Të kontrollojë sistemin e matjes së energjisë elektrike të konsumatorëve;

- Të verifikojë përputhjen e sasisë së energjisë elektrike të faturuar me konsumin sipas fuqisë së instaluar te konsumatori;

- Të bëjë ndërprerjen e energjisë elektrike për rastet e konstatuara si të paligjshme;

- Të evidentojë shkeljet dhe të përgatitë dokumentacionin përkatës për konsumatorët që marrin energji elektrike në mënyrë të paligjshme, që kanë ndërhyrë në sistemin e matjes apo për personat që kanë dëmtuar sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe t'i përcjellë për procedim të mëtejshëm;

- Të bashkëpunojë dhe të kërkojë asistencën e punonjësve të Policisë së Shtetit për të evidentuar rastet në kushtet e flagrancës së veprës penale të vjedhjes së energjisë elektrike apo lidhjes së paligjshme.

b) Në marrëdhënie me shoqërinë OSHEE, sh.a., ka këto të drejta dhe detyra:

- Të kërkojë pranë OSHEE, sh.a.-së, dhe të pajiset në kohë reale me informacionin që e konsideron të nevojshëm për ushtrimin e detyrës, përfshirë aksesin në të dhënat e sistemit "Billing";

- Të kërkojë pranë strukturave të OSHEE, sh.a.-së, marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve, që refuzojnë apo nuk i sigurojnë informacionin e kërkuar në afate të arsyeshme kohore;

- T'i garantohet mbështetja e nevojshme nga OSHEE, sh.a.-ja, për të realizuar kontrollin pranë konsumatorëve të energjisë elektrike;

- Të kontrollojë veprimtarinë e realizuar në terren nga ana e punonjësve të OSHEE, sh.a.-së, për evidentimin dhe ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme;

- Të kërkojë pranë strukturave të OSHEE, sh.a.-së, marrjen e masave disiplinore dhe kryerjen e

kallëzimeve penale, kur është rasti, ndaj punonjësve, të cilët kanë vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre funksionale;

- Në raste të caktuara, të bashkëpunojë me strukturat e shoqërisë OSHEE, sh.a., për realizimin e kontroleve të përbashkëta në terren për zona të caktuara.

c) Detyrat në lidhje me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe marrëdhënia në raport me institucionet e tjera:

- Të raportojë në mënyrë periodike pranë këshillit mbikëqyrës të OSHEE sh.a. dhe ministrisë përgjegjëse për energjinë, rreth zbatimit të detyrave të caktuara;

- Të përgjigjet dhe të kryejë kontrole për çdo çështje të kërkuar nga këshilli mbikëqyrës i OSHEE sh.a. dhe ministri përgjegjës për energjinë;

- Të zbatojë detyrat që i ngarkohen nga Task-Forca, ministri përgjegjës për energjinë ose këshilli mbikëqyrës i OSHEE sh.a.;

- Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse që disponojnë të dhëna për konsumatorët, me qëllim rakordimin e bazës së të dhënave (të tilla si QKB, ZVRPP, degët e tatim-taksave etj.).

5.1.2 Njësia Operacionale Speciale e Task-Forcës ka në përbërje 50 punonjës të specializuar, të cilët kontraktohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Struktura organizative, përshkrimi i detajuar i detyrave, niveli i pagave dhe emërimi i punonjësve përcaktohen me urdhër të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë

5.1.3 Njësia Operacionale Speciale e Task-Forcës sistemohet në ambientet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Vendndodhja dhe adresa përcaktohen me urdhër të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

5.1.4 Fondet e nevojshme për paga, sigurimet shoqërore, shpenzime të tjera operative, si dhe investime përballohen nga shoqëria OSHEE, sh.a.

5.1.5 Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE, sh.a.-së, të miratojë fondin e veçantë për funksionimin e Njesisë Operacionale Speciale të Task-Forcës.

5.1.6 Ngarkohet shoqëria OSHEE, sh.a., që të pajisë me bazën e nevojshme materiale teknike Njësinë Operacionale Speciale të Task-Forcës.

6. Periudha e veprimit të Task-Forcës të jetë deri më deri më 31 dhjetor 2019.

7. Në mbledhjet e Task-Forcës, sipas problematikave që mund të konstatohen, ftohen të marrin pjesë ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara dhe të organeve të qeverisjes vendore, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbushjen e misionit të saj.

8. Ngarkohen zëvendëskryeministri, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë, ministri i Financave, ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe administratori i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., ose OSHEE, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama